

VENDIM
Nr. 1, datë 10.1.2018

**MBI SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA
ERE SHOQËRISË ALBANIAN GREEN ENERGY SHPK, MBAJTËSE E LICENCËS NR.
63, SERIA NPM08P, “PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE EOLIKE (BLOK
MOTORËSH-GJENERATORËSH TË USHQYER ME BIOMASË TË LËNGSHME)”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 11, germa “a”; neni 104, pika 4, germa “a”, nenit 113, pika 1 dhe 3, neni 116, pika 1 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 9, germa “a”, të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së një Licence”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi shtyrjen e afatit të ndërtimit të parkut eolik (blok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme), për shoqërinë Albanian Green Energy sh.p.k.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 89, datë 6.8.2008, ka licencuar shoqërinë Albanian Green Energy sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (blok motorësh-gjeneratorësh të ushqyer me biomasë të lëngshme), Kallmet, Lezhë, me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën “tip” të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike dhe të kushteve të parashikuara në gerrat a, b, c, d, dhe e.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit të parkut eolik me vendimet:

- Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 19, datë 8.3.2010;

- Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 92, datë 6.9.2011;

- Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 138, datë 15.11.2013.

- Me vendimin nr. 88, datë 9.6.2016, të Bordit të ERE-s është vendosur për:

- Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k. për zgjatjen e afatit të licencës nr. 63, seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzim të centrale elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (blok motorësh - gjeneratorësh të ushqyer me biomasë të lëngshme), Kallmet Lezhë, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008.

- Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k., nr. 63, seria NPM08P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008.

- ERE, me shkresën nr. 736 prot., datë 16.11.2017, i është drejtuar ministrisë përgjegjëse për energjinë në mbështetje të nenit 10, pika 2 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” me kërkesën për informacion dhe qëndrimin e institucionit politikbërës të sektorit të energjisë.

- ERE, me urdhrin nr. 67, datë 17.11.2016, dhe urdhrin nr. 17, datë 4.4.2017, ka ngritur grupe pune dhe ka kryer dy monitorime pranë kësaj shoqërie për të kontrolluar dhe konstatuar ecurinë e punimeve dhe nivelin e investimit.

- Nga monitorimi dhe deklaratimet e subjektit është konstatuar se ka pasur vonesa në etapat administrative, dokumentacionin e kërkuar për vijimin e punës, rihapjen, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të antenave matëse, grumbullimin e të dhënave të parametrave të shpejtësisë së erës për plotësimin përfundimtar të studimit të fizibilitetit etj.

- Për zhvillimin e projektit janë bërë investime serioze financiare dhe vonesat në realizimin e projektit janë shkaktuar përtej vullnetit të aplikuesit, i cili rezulton se ka bërë çdo përpjekje të arsyeshme për të përmbushur qëllimin.

- Së fundmi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 2018/1 prot., datë 26.12.2017,

protokolluar me tonën nr. 736/1 prot., datë 27.12.2017, sqaron mes të tjerave se: duhet të merren masa që shtyrja e afatit të ndërtimit të këtyre aplikimeve të bëhet vetëm në rast provueshmërie për arsyet objektive që nuk kanë lejuar realizimin e projekteve brenda afatit të tyre, me qëllim që në vijim të bëhet i mundur vlerësimi dhe prioritizimi i tyre në përputhje me dispozitat e VKM-së 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar.

- Në zbatim të rekomandimeve të institucionit politikbërës, konstatimeve të grupit të monitorimit, dokumenteve të depozituara në ERE nga shoqëria, rezulton së ka arsye objektive që nuk kanë lejuar realizimin e projektit brenda afatit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e pikës 1 të vendimit nr. 88, datë 9.6.2016, të bordit të ERE-s, “Mbi kërkesën e shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 63, seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomase të lëngshme)”, të dhënë me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar.

2. Të mbyllë procedurën e nisur me vendimin nr. 88, datë 9.6.2016, të bordit të ERE-s, për heqjen e licencës nr. 63, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme)”, të dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar.

3. Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura në pikën 1 të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar, shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k., mbajtëse e licencës me nr. 63, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme)”, deri në datën 15.11.2019.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë Albanian Green Energy sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti